

SPECIFIKIME TEKNIKE

Per Objektin: " Sistemimi i rrugëve në laqjen '9 Tetori'(Kasapaj) ;Delvinë"

1 - Germim dheu - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntuorine qe lidhet me germimin e dheut ne cfaredo lloj toke me mina,makineri apo me krahe, per pusetat e portalet e tombinove si dhe aty ku do te vendosen tubot e betonit sic eshte percaktuar ne projekt. Ky cmim perfshin gjithashtu koston e ngarkimit, transportit, shkarkimit, hedhjen ne vendet e autorizuara nga pushteti vendor per depozitimini e materialeve te teperta te evaduara.

Ky çmim i referohet 1 m^3 germim.

Referuar projektit germimi eshte hapi i pare i punes menjehere pas percaktimit te kuotave per sistemimin e trupit te rruges ne segmentin para kopshtit te femijeve.Ne kete faze germimi do te kryhet me krahe.

2 - Shtrese zhavor Tr-10 cm - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntuorise qe lidhet me blerjen ose prodhimin e zhavorit me trashesi minimale 10 cm, hedhjen e tij ne veper, ngjeshjen e tij me rrull , dhe sipas te gjitha kushteve teknike te zbatimit, si dhe cdo gje tjeter e nevojshme. Po ketu duhet te futet edhe kostoja e ngarkimit, transportit, shkarkimit ne objekt te zhavorit.

Ky çmim i referohet 1 m^2 .

2 – Zgare hekuri Ø 4 mm - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntuorise qe lidhet me blerjen ose prodhimin e zgares se hekurit me diameter te shufres 4 mm, vendosjen e tij ne veper , per te kaluar me pas ne lidhjen e zgarave me njera tjetren te cilat kane permaza $2\text{m} \times 4\text{m}(8\text{m}^2)$ te cilat duhet te shkelin 10 cm njera tjetren.

Ky çmim i referohet 1 m^2 .

3 - Shtrese Betoni M-150 Tr-15 cm per rrugen - Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe puntuorise qe lidhen me blerjen ose prodhimin e betonit, , ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, hapjen ne veper, shtrimin e zgarave te betonit,sipas kushteve teknike, sipas profilit te paraqitur ne projekt, me trashesi 15 cm sic percaktohet ne preventiv. Kjo shtrese perdoret ne te gjithe gjatesine e rruges si dhe ne ndertimin e shkallares dhe segmentit rrugor te dyte pjesa e dyte . Pas hedhjes se kesaj shtrese duhet te zbatohen kushtet teknike te ngjeshjes se betonit dhe trajtimit te tij pas hedhjes ne veper.

Ky çmim i referohet 1 m^3 .

4 – Beton M-150 (per kunete) - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntuorise qe lidhet me blerjen e betonit ose te materialeve te nevojshme (si rere, granil, cimento, derrasa per armature betoni dhe cdo gje tjeter e nevojshme) per prodhimin e betonit M-200 per realizimin e kunes, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen ne veper, preqatitjen e armatures se derrases, vibrimin dhe cdo gje tjeter qe lidhet me realizimin e ketij zeri sipas projektit. Betonet duhet jene me granil dhe rere te lare dhe asnjeher me zhavorr lumi, dhe me permasa qe specifikohen ne vizatimet e projektit.

Ky cmim i referohet. 1 m^3 .

5 - Ndertim mur guri Ilac cimento M-30 - Ky çmim perfshin teresine e punimeve qe lidhen me blerjen apo prodhimin e materialeve te nevojshme (si llac cimento, gure dhe cdo gje tjeter), preqatitja e ilacit me cimento M-30 hedhja e tij ne veper, vendosjen e gureve ne mur dhe realizimin e mureve te themelit ne muret mbajtese. Te gjitha keto konform vizatimit tip shoqerues ne projekt.

Ky çmim i referohet 1 m³.

Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit

Marsida Demaj

